



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT ME REKOMANDIME

Ex-officio nr. 631/2019

në lidhje me cenimin e të drejtës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm si pasojë e ndotjes së lumit Graçanka

Drejtuar: Z. Blerim Kuqi, Ministër
Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit

Z. Srđan Popović, Kryetar
Komuna e Graçanicës

Z. Shpend Ahmeti, Kryetar
Komuna e Prishtinës

Kopje për: Z. Goran Rakić, Minister
Ministria e Pushtetit Lokal

Z. Naser Ramadani, Drejtor Ekzekutiv
Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike

Prishtinë, më 9 qershor 2020

Qëllimi i raportit

1. Ky Raport me Rekomandime ka për qëllim që të tërheqë vëmendjen Komunës së Graçanicës, Komunës së Prishtinës, dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit (MEA, në vazhdim ministria) për nevojën e ndërmarrjes së menjëhershme të masave, s'i obligime pozitive për mbrojtjen e lumit Graçanka nga ndotja, tej shfrytëzimi dhe keqpërdorimi, s'i domosdoshmëri për mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve dhe mbrojtjen e mjedisit.
2. Avokati i Popullit, nëpërmjet Raportit mëton që nëpërmjet instrumenteve ndërkombëtare, bazës kushtetuese dhe ligjore, të argumenton në njëërën anë përgjegjësitë e shtetit për evitimin e ndikimit të efekteve të dëmshme të lumit Graçanka, dhe në anën tjetër mos arritjen e autoriteteve për të përmbushur obligimet e tyre, për të penguar ndikimin e ndotjes në të drejtat e njeriut, të drejtën për mjedis të sigurtë dhe të shëndetshëm, të drejtën për jetën dhe të drejtën e privatësisë.
3. Raporti është i bazuar në informatat e pranuar përkritazi me ndotjen e lumit Graçanka, nga mediat dhe autoritetet kompetente qendrore dhe lokale, si dhe vizitës në vendin e ngjarjes të përfaqësuesve të IAP.

Baza ligjore

4. Sipas nenit 135, paragrafi 3, të Kushtetutës: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”*
5. Po ashtu, sipas Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit ka kompetenca:
 - *për t'i hetuar ankesat e pranuar nga çdo person fizik a juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me Kushtetutë, ligje dhe akte tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit” (neni 16, paragrafi 1);*
 - *“të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla” (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2);*
 - *“të bëjë të njohura të drejtat e njeriut dhe përpjekjet për të luftuar të gjitha format e diskriminimit përmes ngritjes së vetëdijesimit, posaçërisht përmes informimit dhe edukimit edhe me anë të mediave” (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4);*
 - *“t'u rekomandojë Qeverisë, Kuvendit dhe autoriteteve tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit” (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5);*
 - *“t'i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta” (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6);*

- *“Avokati i Popullit mund t’i këshillojë dhe t’u rekomandojë autoriteteve të Republikës së Kosovës për programet dhe politikat e tyre për të siguruar mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në Republikën e Kosovës” (neni 18, paragrafi 3).*

Përmbledhja e fakteve

Faktet, dëshmitë dhe informatat të cilat i ka Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), mund të përmbledhen si në vijim:

6. Më 31 korrik 2019, përfaqësuesit e IAP vizituan pjesën e lumit Graçanka, në fshatin Llapna Sellë të komunës së Graçanicës, ku s’i rezultat i keq administrimit, vërehej ndotje si nga mbeturinat e llojeve të ndryshme, po ashtu edhe shkarkimi i ujërave të zeza. Lumi lironte kundërmim, dhe përmbante sasi të ngjyrës së bardhë. Nga informtatat e pranuar nga qytetarët e vendbanimeve në zonën përreth, kuptohet se jeta e tyre është vështirësuar nga gjendja alarmante e lumit, dhe kundërmimi i vazhdueshëm.
7. Më 6 gusht 2019, përfaqësuesit e IAP, takuan drejtorin e drejtorisë së Inspektoratit në Komunës së Graçanicës, dhe Inspektoren përgjegjëse për mjedis nga të cilët u njoftuan se nga lumi lirohet kundërmim i vazhdueshëm, sidomos gjatë periudhës së verës, pasi që të gjitha ujërat e zeza shkarkohen në lum. Në takim u kuptua se Komuna e Graçanicës ka ndërmarrë veprime të vazhdueshme për pastrimin e lumit, mirëpo sipas tyre kjo ka rezultuar pa sukses sepse ndotja si rezultat i shkarkimeve të ndryshme në lum, është më e madhe në krahasim me kapacitetet e komunës për mirëmbajtje.

Inspektorati i Komunës së Graçanicës, kishte vlerësuar se një sasi e ndotjes së lumit vjen nga shkarkimet industriale, jashtë territorit të Graçanicës, të një operatori në fshatin Hajvali, e cila gjendet në Komunën e Prishtinës, dhe që kalon në kompetencë të kësaj të fundit.

Sipas drejtorit, Inspektorati i komunës së Graçanicës përkitazi me problemin e ka njoftuar Komunën e Prishtinës dhe po ashtu edhe Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, (në vazhdim ministria). Inspektorati i ministrisë, nëpërmjet raportit për mbikëqyrjen inspektive të rrjedhës së lumit Graçanka, datë 4 korrik 2019, kishte vlerësuar ndotje të rëndë të lumit nga ujërat e zeza sanitare, dhe kishte konstatuar se mbrojtja e shtretërve të lumenjëve, etj. është kompetencë e komunave.
8. Meqenëse, ndotja e ujërrjedhës së lumit Graçanka, tejkalonte kompetencën e vetëm një komune, më 2 shtator 2019, përfaqësueset e IAP takuan Sekretaren e Përgjithshme të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), dhe kërkuan nga MAPL ngritjen e çështjes në nivel qendror për të diskutuar rreth mënyrave për sanimin e ndotjes. E njëjta theksoi se MAPL, do ta merr me përgjegjësi dhe prioritet këtë çështje, dhe do t’i ftojë bashkërisht në një takim ministrinë dhe komunat kompetente për të diskutuar për mënyrën e bashkërendimit të veprimeve për zgjidhjen e problemit.
9. Më 17 shtator 2019, Ministria e atëhershme e MAPL, organizoi takim në të cilin u diskutua përkitazi me ndotjen e lumit Graçanka, dhe në të cilin morrën pjesë Avokati i Popullit dhe Zëvendësja e Avokatit të Popullit, Ministri i atëhershëm, dhe shefja e Inspektoratit të ministrisë, dhe Drejtori i drejtorisë së Urbanizmit të Komunës së Graçanicës. Edhe pse, në takim ishin ftuar edhe krerët e Komunës së Prishtinës dhe Komunës së Fushë Kosovës, këta të fundit nuk i’u përgjigjën takimit. Avokati i Popullit,

në takim konsideroi se çështja në fjalë përbën shkelje të së drejtës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, shkelje të privatësisë dhe të së drejtës për jetë, të drejta këto të garantuara me Kushtetutë dhe me legjislacionin në fuqi, dhe kërkoi nga autoritetet përgjegjëse t'i ndërmarrin veprime të duhura dhe të menjëhershme për evitimin e parregullësive. Në takim përfaqësuesit e autoriteteve të lartpërmendura u dakorduan që nëpërmjet investimeve kapitale, përkatësisht inicimit të procedurave për zhvillimin dhe implementim të projekteve kapitale, t'i bëhet zgjidhje afatgjate ndotjes së lumit.

10. Më 18 dhjetor 2019, përfaqësuesja e IAP, i është drejtuar Divizionit për Planifikim të Resurseve Ujore në MMPH me kërkesë për të marr informata përkitazi me veprimet e ndërmarra dhe ato që planifikohen të ndërmerren për sanimin e gjendjes së lumit në fjalë.
11. Më 13 janar 2020, IAP ka marr përgjigje nga zyrtarja për menaxhimin e projekteve në Autoritetin Rajonal të Pellgjeve Lumore (autoriteti është organ që i raporton ministrisë) nëpërmjet të cilës është informuar se MMPH, i është drejtuar komunave me kërkesë, për paraqitjen e projekt propozimeve në fushën e ujërave. Rrjedhimisht, me këtë kërkesë është kërkuar që komunat t'i paraqesin në mënyrë analitike sfidat në fushën e ujërave dhe nevojën për marrjen e masave ndaj tyre, duke përfshirë rregullimin, pastrimin, rehabilitimin e lumenjëve, etj. Gjithsesi, përveç këtyre informatave, IAP nuk është vënë në dijeni nëse MMPH ka marr ndonjë projekt propozim nga komuna e Graçanicës për sanimin e lumit Graçanka. Po ashtu, nga informatat e pranuar nga IAP, është njoftuar se rregullimi i përroit Kravarica në territorin e komunës së Prishtinës dhe të Graçanicës, është përfshirë në listen e projekteve kapitale për vitin 2019 i cili është realizuar po në këtë vit.
12. Lidhur me kërkesën për sqarime përkitazi me komunikimin e datës 13 janar 2020, të pranuar nga Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore, Avokati i Popullit, më 28 janar 2020, pranoi përgjigje s'i në vijim (citim origjinal) "*Për lumin Kravarica në Llapnasellë K.Graçanicë, me realizimin e këtij projekti janë ndërmarrë masat me realizimin e projektit, është rregulluar rrjedha e lumit, pastrimi I lumit, nje pjese e lumit afer fakultetit te Bujqesis eshte mbuluar per shkak tekundermimit te eres, pastaj ka vazhduar mbulimi I lumit edhe te banesat e reja sociale, si dhe ka vazhduar pastrimi dhe eshte rregulluar rrjedha e lumit deri te kisha e Llapnasellës*".
13. Më 6 shkurt 2020, përfaqësuesja e IAP nëpërmjet postës elektronike, i është drejtuar Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK), për të marr informata nëse kjo e fundit si autoritet përgjegjës për hulumtimin e ndikimit të faktorëve mjedisor në shëndetin e popullsisë, ka ndërmarr veprimet konkrete lidhur me çështjen në bazë të kompetencave ligjore që i ka. Drejtori i IKSHPK-së e ka njoftuar përfaqësuesen e IAP se autoriteti që ai e udhëheqë nuk kishte pranuar ndonjë kërkesë nga autoritetet relevante për vlerësimin e gjendjes sanitaro-higjienike në lumin Graçanka, andaj i njëjti kërkoi nga IAP informata shtesë dhe dokumentacionin relevant për t'i ndërmarrë veprimet e menjëhershme.
14. Më 14 shkurt 2020, IKSHPK i ka dërguar IAP-së raportin e detajuar në të cilin ka bërë vlerësimin e gjendjes aktuale sanitaro-higjienike dhe epidemiologjike në Komunën e Graçanicës, nga ndotja e lumit Graçanka, në vendbanimin Llapna Sellë. Raporti pasqyron gjendjen e rëndë të ndotjes së lumit dhe rekomandon autoritetet përgjegjëse t'i ndërmarrin masat e menjëhershme në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësisë ligjore që kanë për

rregullimin e dhe mirëmbajtjen e lumit. Ekipi i IKSHPK bashkë me zyrtarët komunal gjatë vëzhgimit të ujërrjedhës së lumit, në muajin shkurt 2020, kanë vërejtur:

- *Mungesë të mirëmbajtjes së shtratit të lumit*
- *Mbeturina dhe shkarkim direkt të ujërave të zeza*
- *Shtëpitë banuese janë afër lumit, shumë prej të cilave nuk janë të kyçura në sistemin e kanalizimit dhe ujërat e zeza shkarkohen direkt në lum*
- *Komuna nuk ka sistem të trajtimit të ujërave të zeza*
- *Në këtë territor furnizimi me ujë të pijshëm bëhet nga sistemi qendror i ujësjellësit KRU "Prishtina", dhe*
- *Grumbullimi i mbeturinave bëhet njëherë në javë nga kompania "Pastrimi"*

Instrumentet ligjore të zbatueshme në Republikën e Kosovës

15. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 21, përcakton: "*Republika e Kosovës mbrohet dhe garanton të drejtat e njeriut dhe liritë themelore [...]".*
16. Kushtetuta e Republikës së Kosovës i garanton secilit qytetar, të drejtën për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm. Përgjegjësia për mjedisin jetësor, përcaktohet me nenin 52 të Kushtetutës: "*1.Natyra dhe biodiversiteti, mjedisi jetësor dhe trashëgimia kombëtare, janë përgjegjësi për secilin. 2.Institucionet e pushtetit publik angazhohen për t'i garantuar secilit mundësinë që të ndikojë në vendimet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor ku ajo/ai jeton. 3.Ndikimi në mjedisin jetësor merret parasysh nga institucionet publike në procesin e marrjes së vendimeve."*
17. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ), e cila sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është dokument ligjor drejtpërdrejt i zbatueshëm në Republikën e Kosovës dhe ka prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave, ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike,¹ në nenin 13 përcakton të drejtën për zgjidhje efektive: "*Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare".*
18. E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare, përcaktohet me nenin 8 të KEDNJ, "*Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe..."*
19. Në mënyrë që të drejtat dhe liritë themelore, të garantuar me Kushtetutën e vendit, të interpretohen në pajtim me vlerat e shoqërisë së hapur dhe demokratike dhe në pajtim me praktikën e organeve ndërkombëtare, të cilat i mbikëqyrin ato, Kushtetua, në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], ka precizuar: "*Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut."*
20. Ligji Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, (këtu e tutje referuar si: Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit), në nenin 1, paragrafi 2 shprehimisht përcakton: "*Qëllimi i këtij ligji është të promovojë krijimin e mjedisit të shëndetshëm për popullin e Kosovës me sjelljen graduale*

¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22.

të standardeve për mjedis të Bashkimit Evropian”. Ligji në nenin 2 paragrafi 2 saktëson shprehimisht që “Ky ligj synon [...] përmirësimin e kushteve mjedisore, që lidhen me cilësinë e jetës dhe mbrojtjen e shëndetit të njeriut [...] bashkërendimin e veprimtarive shtetërore për të përmbushur kërkesat për mbrojtjen e mjedisit[...].”

21. Ligji nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, (këtu e tutje referuar si: Ligji për Ujërat) i cili ka për qëllim të sigurojë zhvillimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve ujore, të cilat janë të domosdoshme për shëndetin publik, mbrojtjen e mjedisit, zhvillimin social-ekonomik, mbrojtjen e resurseve ujore nga ndotja, tej shfrytëzimi dhe keqpërdorimi², në nenin 1, duke i dhënë **karakter resurseve ujore “pasuri me interes të përgjithshëm dhe pronë e Republikës së Kosovës që ruhen e mbrohen me ligj”**, i mvesh organet kompetente me kompetenca dhe përgjegjësi për mirëadministrimin e ujërave.
22. Ligji për Ujërat specifikon disa nga parimet për administrim të qëndrueshëm, ndër të tjera po i përmendim dy prej tyre: “1.2 **Parimin e përkujdesjes-nëse** ekziston rreziku se aktiviteti i caktuar mund të shkaktojë veprim të dëmshëm në ujërat ose veprim të dëmshëm nga ujërat, por për të nuk ka dëshmi shkencore, ndërmerren masa të bazuara në vlerësimin përkatës të rrezikut, të domosdoshme që të sigurohet nivel i lartë i mbrojtjes së ujërave dhe nga ujërat” dhe 1.6 **Parimin „ndotësi paguan”**-që do të thotë se çdo person që shkakton apo lejon shkarkime të ndotjes, do të përgjigjet financiarisht dhe penalisht, për të gjitha shpenzimet që dalin, përfshirë edhe shpenzimet për parandalimin e ndotjes, masat e nevojshme kontrolluese, shpenzimet administrative, shpenzimet riparuese apo kompensuese, në pajtim me këtë ligj;
23. Ligji Nr. 03/L-160 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja (këtu e tutje referuar si: Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja), i cili ka për qëllim të rregulloj dhe garantoj të drejtën e qytetarëve për të jetuar në një mjedis me ajër të pastër, duke mbrojtur shëndetin e njeriut, faunën, florën dhe vlerat natyrore e kulturore të mjedisit”, në nenin 8 përcakton detyrimet e përgjithshme të burimeve të ndotjes: “1. Çdo person juridik dhe fizik, duhet ta ruaj cilësinë e ajrit, ta mbrojë atë nga ndotjet e shkaktuara gjatë veprimtarisë që ushtrohen në territorin e Republikës së Kosovës [...]”.
24. Ligji Nr. 04/L-175 për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit, në nenin 10, paragrafi 1 përcakton: “Inspektorati i mbrojtjes së mjedisit ushtron mbikëqyrjen inspektive dhe kontroll përmes inspektimit mjedisor në zbatimin e këtij ligji dhe ligjeve që kanë të bëjnë me fushën e mbrojtjes së mjedisit”, kurse neni 34 përcakton: “Inspektori mundet të kërkojë në kuadër të procedurës inspektuese mendim dhe bashkëpunim profesional nga institucionet relevante, nëse kjo është e nevojshme për vlerësim të drejtë të gjendjes faktike”.
25. Ligji Nr.02/L-109 për Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse, parasheh ndërmarrjen e masave për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse, përmes nenit 8, paragrafi 8.2 i cili përcakton: “Masat e përgjithshme për mbrojtje nga sëmundjet ngjitëse janë [...] Mënjanimi i ujërave të ndotura dhe hedhurinave sipas mënyrës dhe nën kushtet në të cilat sigurohet mbrojtja nga ndotja e ujit dhe e tokës, si dhe mbrojtja nga shtimi i insekteve dhe i brejtësve [...]”.

² Ligji i veçantë nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, Neni 2. 1 dhe 2.3.

26. Ligji Nr.02/L-78 për Shëndetësinë Publike, neni 6, paragrafi 6.1 përcakton: "Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHP) hulumton ndikimin e faktorëve mjedisor në shëndetin e popullsisë dhe i propozon masat mbrojtëse për parandalimin e efekteve të dëmshme për shëndet" kurse paragrafi 6.2 përcakton: "IKSHPK propozon dhe ndërmerr veprime profesionale dhe u rekomandon institucioneve kompetente eliminimin e mangësive të zbuluara dhe çfarëdo efekti të dëmshëm për shëndet".
27. Ligji për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, në nenin 17, përcakton: "Komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar: [...] e) mbrojtjen e mjedisit lokal, f) ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transportit lokal dhe skemave të nxehtësie lokale, i) promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut [...]".
28. Ligji për Ujërat e Kosovës, në nenin 49, par. 1, përcakton se: "1. Kompetent për mbrojtjen e shtretërve, brigjeve të ujë rrjedhave, kanaleve, tuneleve dhe akumulimeve ujore, janë:
1.1. brenda zonave urbane, komunat;
1.2. brenda kufirit të rajonit të pellgjeve lumore, Autoriteti.
1.3. Ministria përcjell dhe mbikëqyrë punët dhe aktivitetet e ndërmarrja për mbrojtjen e brigjeve të ujë rrjedhave dhe akumulimeve."
29. Ligji për Ujërat e Kosovës, neni 93 shprehimisht përcakton se: "Zbatimin e këtij ligji dhe akteve tjera nënligjore të miratuara në bazë të këtij ligji, e bënë Ministria." Ndërsa neni 94 i këtij ligji [Mbikëqyrja Inspektuese], në paragrafin 1 dhe 2 specifikon si në vijim: "1. Punët e mbikëqyrjes inspektuese për zbatimin e këtij ligji dhe dispozitave të nxjerra në bazë të këtij ligji i kryejnë Inspektorët e ujërave të Ministrisë dhe inspektorët e autorizuar të ujërave të komunave. 2. Inspektori i ujërave kryen mbikëqyrjen inspektuese të ujërave nën nivel të Kosovës, ndërsa inspektori i autorizuar i ujërave kryen mbikëqyrjen inspektuese të ujërave në nivele komunale".

Analiza ligjore

30. Vlerësimet dhe konstatimet e Avokatit të Popullit përkitazi me ndotjen e lumit Graçanka, bazohen në të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjet e zbatueshme në vend, KEDNJ dhe praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNJ).
31. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (këtu e tutje referuar si: Kushtetuta), mjedisit dhe mbrojtjes së saj i ka përcaktuar vend të veçantë duke e renditur jo vetëm në kapitullin e të Drejtave dhe Lirive Themelore, por edhe në mesin e vlerave në të cilat bazohet rendi kushtetues. Neni 7 [Vlerat] "1. Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet ..., respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit [...]".
32. Kushtetuta, duke i dhënë fuqinë e parimit imperativ, në nenin 52, paragrafi 1, shprehimisht përcakton përgjegjësinë e të gjithëve pa përjashtim për mbrojtjen e mjedisit jetësor duke theksuar se: "Natyra dhe biodiversiteti, mjedisi jetësor dhe trashëgimia kombëtare, janë përgjegjësi për secilin".

33. Avokati i Popullit, duke u bazuar në nenin në nenin 53, [*Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut*], të Kushtetutës, sipas së cilit të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, gjen që KEDNJ, edhe pse nuk garanton shprehimisht një të drejtë për mjedis të sigurt, të qetë dhe të shëndetshëm, në mënyrë indirekte ofron një shkallë të caktuar mbrojtjeje përsa i përket çështjeve të mjedisit, nëpërmjet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GjEDN). Sipas praktikës së GjEDNj, autoritetet publike janë të detyruara të ndërmarrin masa konkrete për të siguruar që të drejtat e njeriut të mos preken seriozisht nga faktorë të dëmshëm mjedisor.
34. E Drejta e Privatësisë, sipas së cilës “*Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës, [...]*”, është e përcaktuar në nenin 8, par.1 të KEDNJ. Sipas praktikës së GjEDNj, e drejta për mjedis të shëndetshëm zë një vend të veçantë në nenin 8. Kjo e drejtë nënkupton respektimin e cilësisë së jetës private si dhe gëzimin e kushteve të shtëpisë “hapësirave të jetuarit” të një personi³. Bazuar në praktikën e GjEDNj, ndotja e rëndë e mjedisit, nga nivelet i larta të kundërmimit, zhurmës, tymit, emetimeve toksike, mund të paraqesin ndërhyrje në gëzimin e qetë të shtëpisë së një personi, madje edhe kur ndotja nuk përbën kërcënim serioz për shëndetin tij⁴. Në vendimin *Lopez Ostra kundër Spanjës*, gjykata ka vlerësuar se “cenimi i rëndë i mjedisit mund të prekë mirëqenien e një personi dhe ta privojë atë nga vendbanimi i tij duke dëmtuar jetën e tij private dhe familjare”.
35. Ndikimi i ndotjes së mjedisit në mirëqenien e qytetarëve po ashtu pasqyrohet edhe në rastin e GjEDNj, *Guerra dhe të tjerët kundër Italisë*. Gjykata ka vlerësuar që ndotja e mjedisit mund të ndikojë në mirëqenien e individëve dhe të parandalojë gëzimin e shtëpisë, në mënyrë të tillë, duke ndikuar negativisht në jetën private dhe familjare. Gjykata u shpreh se shteti i paditur nuk ka përmbushur detyrimin e tij pozitiv për të siguruar të drejtën e ankuesve për të respektuar jetën e tyre private dhe familjare, që bie në kundërshtim me Nenin 8 të Konventës.
36. Praktika e GjEDNj-së, në kuadër të nenit 2 të Konventës [*E drejta për jetën*], jep mendimin që shteti duhet të vendosë detyrime pozitive për ndërmarrjen e masave të nevojshme për të mbrojtur jetën e qytetarëve brenda juridiksionit të tij. Neni 2 i obligon autoritetet publike që të ndërmarrin hapa për t’i garantuar të drejtat që parasheh Konventa, madje edhe kur të drejtat kërcënohen nga persona të tjerë (privat) ose aktivitetet që nuk janë drejtpërdrejt të lidhura me shtetin. Sipas Gjykatës, obligimi pozitiv i shteteve mund të aplikohet në kontekst të aktiviteteve të rrezikshme, funksionimit të fabrikave të kimikateve me emetime toksike, ose vendeve të grumbullimit të mbetjeve, qoftë të transportuara nga vetë autoritetet publike ose nga kompani private. Në përgjithësi, shkalla e detyrimeve të autoriteteve publike varet nga faktorët se sa është ndikimi i aktiviteteve të rrezikshme dhe parashikimi i rrezikut për jetën.
37. Duke pasur parasysh gjendjen e lumit Graçanka, ndotjen e skajshme të lumit si nga shkarkimet, ashtu edhe nga hudhja e mbeturinave të ndryshme, Avokati i Popullit, konsideron që Ligji për Ujërat e Kosovës, qëllimi i të cilit është mbrojtja e resurseve ujore nga ndotja, tej shfrytëzimi dhe keqpërdorimi, nëpërmjet dispozitave të tij, ka paraparë

³ *Powell & Rayner kundër Mbretërisë së Bashkuar*

⁴ *Taşkın dhe të tjerët kundër Turqisë*

mjaftueshëm ndalimin e ndotjes së lumenjëve. Neni, 48, par. 1.2, ka specifikuar që me qëllim të mbrojtjes së shtretërve, brigjeve të ujërrjedhave, kanaleve, tuneleve, akumulimeve të ujërave, është e ndaluar: “nxjerrja e rërës, zhavorrit, gurëve, deponimi i dheut, hudhja e mbeturinave, materialeve të ngurta dhe shkarkimii materieve të lëngëta në ujërrjedha, liqene, akumulime dhe në brigjet e tyre”.

38. Për më tepër, neni 60, par. 1, i ligjit, derivon mesazh imperativ, duke saktësuar decidivisht që: “Ndalohet, përveç me leje ujore, shkarkimi i masës nga hedhurinat e lëngëta industriale, bujqësore dhe ujërave të ndotura urbane si dhe vajrave të përdorura në kanalizim, në sistemin për kullim, në trupat ujorë sipërfaqësorë dhe nëntokësorë, në brigjet buzë lumit dhe tokave të lagëta.”
39. Në vazhdim neni 63 [Hudhja e substancave dhe mbeturinave], nuk ka lënë asnjë hapësirë për krijimin e gjendjes së tanishme të lumit, dhe hapësirë të neglizhimin e çështjes nga autoritetet kompetente duke saktësuar se:
1. “Ndalohet hudhja e substancave dhe mbeturinave të ngurta, të lëngëta dhe të gazta të cilat për shkak të vetive fizike, kimike dhe biologjike, rrezikojnë shëndetin e njerëzve, cilësinë e ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë, florën dhe faunën ujore, vështirësojnë rrjedhjen e ujërave, rrezikojnë objektet dhe pajisjet ujore.
 2. Ndalohet çfarëdo lloj i transportimit të substancave, materieve dhe mbeturinave të rrezikshme pranë akumulimeve dhe zonave ujore të mbrojtura përveç me leje të veçantë.
 3. Ndalohet çfarëdo lloj ndërtimi i objekteve dhe pajisjeve të dedikuara për prodhimin e substancave dhe materieve të rrezikshme në afërsi të trupave ujorë sipërfaqësorë dhe nëntokësorë, përfshirë edhe akumulimet”.
40. Avokati i Popullit, konsideron se dispozitat më lartë, duke specifikuar mjaftueshëm ndalimin për shkarkimin dhe hudhjen e mbeturinave të llojeve të ndryshme në lumenjë, në të njëjtën kohë derivojnë obligime për organet kompetente për ndërmarrjen e veprimeve për parandalimin dhe pengimin e ndotjes. Rrjedhimisht, gjendja e lumit Graçanka, në tërë ujë rrjedhën e saj, është tregues i dështimit të komunës së Garçanicës dhe Prishtinës, e në veçanti Ministrisë për përmbushjen e obligimeve ligjore efektive për parandalimin e ndotjes, përmes masave vetëdijësuese, atyre ndëshkimore, dhe po ashtu masave tjera për mirëadministrimin e ujë rrjedhës.
41. Avokati i Popullit, gjen se gjykata në rastin *Dubetska dhe të tjerët kundër Ukrainës*, në të cilin për arsye të mosarritjes së gjetjes së zgjidhjes efektive për ndalimin e ndotjes nga autoritetet, gjeti shkelje të nenit 8, dhe vlerësoi se nuk ka dyshim se ndotja mund të ndikojë negativisht në shëndetin publik në përgjithësi, dhe përkeqëson cilësinë e jetës së një individi, edhe pse shpesh është e pamundur për të përcaktuar efektin e saj në secilin rast individual. Në këtë rast u theksua se, të jetosh në një zonë me tejkalime të qarta të standardeve të lejuara nga ndotja, përbën rrezik të lartë për shëndetin.
42. Ligji më tej në nenin 49, par. 1, në mënyrë të qartë përcakton se kompetent për mbrojtjen e shtretërve, brigjeve të ujë rrjedhave, 1.1. brenda zonave urbane, janë **komunat**, ndërsa, par. 1.2. brenda kufirit të rajonit të pellgjeve lumore, **Autoriteti**. Ndërsa, barën për mbikqyrjen e aktiviteteve për mbrojtjen e ujërave sipas par 1.3. e bart **Ministria**, e cila “përcjell dhe mbikëqyrë punët dhe aktivitetet e ndërmarra për mbrojtjen e brigjeve të ujë rrjedhave dhe akumulimeve”.

43. Për më tepër, detyrat e komunës për mbrojtjen e mjedisit brenda territorit të vet i ka saktësuar, Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, i cili në nenin 17, përcakton se Komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, për sa i përket interesit lokal, *“planifikimin urban dhe rural, mbrojtjen e mjedisit lokal, ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave... mbrojtjes së të drejtave të njeriut, ... shëndetësinë publike;”*.
44. Avokati i Popullit, vlerëson që përkundër bazës së mjaftueshme ligjore e cila përcakton qartë kompetencat e organeve komunale dhe qendrore në drejtim të mbrojtjes dhe menaxhimit të ujë rrjedhave gjendja në terren dëshmon se komuna e Graçanicës brenda territorit të vet, përkundër pretendimeve për investime dhe mirëmbajtje nuk ka arritur që të siguroj mbrojtje efektive të lumit nga ndotja, tej shfrytëzimi dhe keqpërdorimi..
45. Për më tepër, Avokati i Popullit, nuk ka arritur të ketë qasje në informata të cilat do të dëshmonin ndërmarrjen e veprimeve nga Komuna e Prishtinës, marr parasysh që ujërrjedha e lumit kalon përmes fshatit Hajvali, vend në të cilin sipas pretendimeve të komunës së Graçanicës bëhet shkarkimi i ujërave të ndotur, dhe i cili gjendet brenda territorit të komunës së Prishtinës. Tregues i neglizhimit të çështjes nga Komuna në fjalë, është mos edhe mos përfillja e kërkesave të komunës së Graçanicës për bashkëpunim, dhe mos përgjigja në ftesën e MAPL, për takim.
46. Në këtë drejtim, përkundër gjendjes alarmante dhe reagimit të vazhdueshëm të qytetarëve përkritazi me ndotjen e lumit dhe ndikimit në të drejtat e qytetarëve, dhe pretendimeve të komunës së Graçanicës për mos arritjen e kontrollimit të ujërrjedhës së lumit për arsye të tejkalimit të hapësirave të saj territoriale, Avokati i Popullit, në bazë të analizës ligjore vëren që dispozitat e Ligjit për Ujërat, nuk lënë asnjë hapësirë e cila do ta arsyetonte neglizhencën e Autoritetit/Ministrit, dhe lirimit të tyre nga përgjegjësia e krijimit të gjendjes alarmante të lumit.
47. Avokati i Popullit, duke e vlerësuar shqetësuese heshtjen e ministrit si organ kompetent përkundër fuqisë së dhënë nga baza ligjore karshi gjendjes së krijuar, sjell në vëmendje nenin 13, Ligjit për Ujërat, i cili saktëson që Ministria ka për përgjegjësi dhe obligim *“1.2 zbatimin e ligjeve dhe akteve nënligjore nga fusha e resurseve ujore, përfshirë edhe ligjet tjera nga fusha e mjedisit jetësor.... 1.5. administrimin dhe menaxhimin e të gjitha resurseve ujore në territorin e Republikës së Kosovës, 1.6. kryerjen e të gjitha punëve dhe aktiviteteve administrative, profesionale dhe punëve tjera organizative dhe zhvillimore që obligohen me këtë ligj”*.
48. Neni 49, par 1.2, dhe të Ligji për Ujërat, e Kosovës, përcakton **“Autoritetin”**, si organ kompetent për mbrojtjen e shtretërve, brigjeve të ujë rrjedhave, kanaleve, *“brenda kufirit të rajonit të pellgjeve lumore”*. **Autoriteti, i cili sipas ligjit i raporton ministrit**, bazuar në nenin 22 të ligjit, është i detyruar të ndërmerr masa të nevojshme për ruajtjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, 1.6. harton planet për menaxhim e ujërave për pellgun, 1.8. përkujdeset për zbatimin e masave për mbrojtje nga efektet e dëmshme të ujërave në pellg.
49. Në vazhdim, Avokati i Popullit vëren se edhe përkundër gjendjes së lumit, asnjëri nga organet kompetente nuk ka ndërmarrë masa sanksionuese ndaj ndotësve. Avokati i Popullit sjell në vëmendje që neni 93 i ligjit, shprehimisht përcakton se: *“Zbatimin e këtij*

ligji dhe akteve tjera nënligjore të miratuara në bazë të këtij ligji, e bënë Ministria,”, Neni 94, par 1 dhe 2 i ligjit të Ujërave, i cili saktëson që *“Punët e mbikëqyrjes inspektuese për zbatimin e këtij ligji të ujërave dhe dispozitave të nxjerra në bazë të këtij ligji i kryejnë Inspektorët e ujërave të Ministrisë dhe inspektorët e autorizuar të ujërave të komunave. 2. Inspektori i ujërave kryen mbikëqyrjen inspektuese të ujërave nën nivel të Kosovës, ndërsa inspektori i autorizuar i ujërave kryen mbikëqyrjen inspektuese të ujërave në nivele komunale”*.

50. Duke pasur parasysh raportin e Ministrisë, me rastin e inspektimit të gjendjes në terren, i cili mund të vlerësohet se reflekton mos interesim për zgjidhjen e çështjes, përkundër obligimeve ligjore, me arsyetimin se çështja hyn në kompetencat komunale, edhe pse lumi i tejkalonte kufijtë e një komune, Avokati i Popullit, sjell në vëmendje nenin 97, të Ligjit për Ujërat e Kosovës, i cili përcakton një gamë të gjerë të përgjegjësisive të Inspektorit të ujërave dhe inspektorit të autorizuar të ujërave⁵.
51. Po ashtu, neni 47, par. 1, të Ligjit Nr. 04/L-175 për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit, ka paraparë që *“Mbikëqyrja inspektuese mund të kryhet njëkohësisht, nga më shumë organe inspektuese”*.
52. Dështimi i autoriteteve për të vënë nën administrim rrjedhën e lumit Graçanka, është një tregues i mos arritjes organeve komunale, e po ashtu qendrore për respektimin e përgjegjësisë kushtetuese për mbrojtjen e resurseve ujore, dhe pengimin e ndikimit në të drejtat e qytetarëve. Duke marrë parasysh mendimin e GjEDNJ-së se *“të jetosh në një zonë me tejkalime të qarta të standardeve të lejuara nga ndotja, përbën rrezik të lartë për shëndetin”*⁶, gjatë hetimit të rastit, përkundër, degradimit të shkajshëm të lumit Graçanka, dhe mundësisë së ndikimit të ndotjes në shëndetin e qytetarëve vërehet se autoritetet asnjëherë nuk kishin kërkuar vlerësim zyrtar nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHP)⁷, për mundësinë e ndikimit të ndotjes në shëndetin e qytetarëve, dhe as nuk ofruan dëshmi për ndërmarrjen e masave kundërvajtëse apo penale.

⁵ Ligji për Ujërat e Kosovës, neni 97, Fushëveprimi i Inspektorit të ujërave dhe inspektorit të autorizuar të ujërave. Inspektori i ujërave dhe inspektori i autorizuar i ujërave në kuadër të kompetencave të përcaktuara me këtë ligj dhe ligjet tjetëra, ka të drejtë, të: 1.1. kontrollojë dhe të konstatojë nëse shfrytëzimi i përgjithshëm i ujërave realizohet në përputhje me këtë ligj; 1.2. kontrollojë dhe të konstatojë nëse me truallin rreth bregut veprohet në përputhje me këtë ligj; 1.3. kontrollojë dhe të konstatojë nëse personat juridikë që menaxhojnë me pellgjet ujore kanë hartuar programe për mbrojtje nga ndikimi i dëmshëm i ujërave; 1.4. kontrollojë dhe të konstatojë nëse personat juridikë që menaxhojnë me pellgjet ujore i ndërmarrin masat dhe aktivitetet e nevojshme për mbrojtje nga ndikimi i dëmshëm i ujërave; ...; kontrollojë të gjitha punët e sistemit ujor, ndërtimit të objekteve dhe të gjitha punëve të cilat mund të shkaktojnë ndryshime cilësore dhe sasiore në regjimin ujor; 1.8. kontrollojnë zbatimin e kushteve të lejes ujore; 1.9. vrojtojnë dhe kontrollojnë planet e menaxhimit të pellgut lumor; 1.10. kontrollojë realizimin e planeve dhe programeve të Autoritetit; 1.11. kontrollojë mënyrën e shfrytëzimit të objekteve dhe impianteve; 1.12. kontrollojë rezultatet e matjeve, sasisë dhe cilësisë së ujërave të përdorura dhe ujërave të ndotura, si dhe materialeve të nxjerra nga ujë rrjedhat; 1.13. kontrollojë funksionimin dhe rregullsinë e impianteve për pastrimin e ujërave; 1.14. kontrollojë rregullsinë e veprimit të objekteve mbrojtëse ujore dhe objekteve për shfrytëzimin e ujërave; 1.15. kontrollojë rregullsinë e pajisjeve për përcaktimin e sasisë së ujërave të përdorura dhe ujërave të ndotura të shkarkuara; ...

⁶ Dubetska dhe të tjerët kundër Ukrainës

⁷ Ligji Nr.02/L-78 për Shëndetësinë Publike, neni 6, par. 6.1, i, *“Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHP), është autoritet përgjegjës i cili “hulumton ndikimin e faktorëve mjedisor në shëndetin e popullsisë dhe propozon masat mbrojtëse për parandalimin e efekteve të dëmshme për shëndet”*. Instituti, sipas paragrafit 6.2 është kompetent që në rast nevojë të *“propozon dhe ndërmerr veprime profesionale dhe u rekomandon institucioneve kompetente eliminimin e mangësive të zbuluara dhe çfarëdo efekti të dëmshëm për shëndet”*.

53. Më 14 shkurt 2020, IAP, ka pranuar nga IKSHPK raportin për vlerësimin e gjendjes aktuale sanitaro-higjienike dhe epidemiologjike në Komunën e Graçanicës, në vendbanimin Llapna Sellë dhe zonën përreth, nga ndotja e lumit Graçanka. Sipas IKSHPK, përveç kërkesës së IAP, nuk kishte pranuar asnjë kërkesë nga institucionet relevante për vlerësimin e gjendjes së lumit. Lidhur me ndotjen e lumit ishte raportuar në vitin 2015, në Raportin për Gjendjen e Ujërave në Republikën e Kosovës⁸, të publikuar nga MMPH, në të cilin theksohet se: *“cilësia e ujit të lumit Graçanka vlerësohet në vazhdimësi e ndotur si rezultat i pompimit të ujërave nga minierat e Kishnicës dhe Artanës. Ka vlera të larta të përçueshmërisë elektrike dhe të jonit sulfat dhe se gjatë stinës së ngrohtë të verës ky lum shteron”*. Për më tepër, IKSHPK, njoftoi se në nëntor të vitit 2018, Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK) ka marr 6 mostra për ekzaminim laboratorik, 3 mostra përgjatë rrjedhës së lumit dhe 3 mostra nga pusët në afërsi të lumit. Mostrat kanë rezultuar me tejkallim të vlerave parametrike të SHBO⁹, dhe detergjentet dhe fosfatet vërtetojnë kontaminimin kimik të ujit në lum. Sipas rezultateve të analizave laboratorike dhe gjetjeve në terren, instituti konstatoi se ndotja e ujit është rezultat i aktiviteteve që zhvillohen në afërsi të rrjedhës së lumit si dhe derdhjes direkte të ujërave të patrajuara. Përveç tjerash IKSHK është informuar nga Drejtori për Shëndetësi në Komunën e Graçanicës, se vitet e fundit nga 5 Qendra Komunale të Mjekësisë Familjare në këtë komunë është raportuar për rritje të rasteve të sëmundjeve respiratore.
54. Avokati i Popullit, në mungesë të ndonjë argumenti i cili do të dëshmonte tendencën e organeve kompetente, sidomos inspektorateve për të bashkëpunuar me institucione tjera për zgjidhjen e çështjes, dhe bazuar në informatën e IKSHPK, sipas së cilës *“IKSHPK, përveç kërkesës së IAP, nuk kishte marr asnjë kërkesë nga institucionet relevante për vlerësimin e gjendjes së lumit”*, gjen që neni 34, i Ligjit për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit, përcakton shprehimisht që *“Inspektori mundet të kërkojë në kuadër të procedurës inspektuese mendim dhe bashkëpunim profesional nga institucionet relevante, nëse kjo është e nevojshme për vlerësim të drejtë të gjendjes faktike”*.
55. Shqetësuese vlerësohet të jetë informata e pranuar nga IKSHPK, sipas së cilës bazuar në të dhënat nga Departamenti i Epidemiologjisë, nuk bëhet asnjë raportim i çfarëdo natyre nga institucionet shëndetësore të Komunës së Graçanicës, të problemeve të shëndetësisë publike e në veçanti të sëmundjeve ngjitëse. Instituti ka shprehur shqetësimin për situatën epidemiologjike në këtë komunë, posaçërisht në fshatin Llapna Sellë, që sipas tyre gjendja aktualisht është e qetë por e pa sigurtë nëse ky problem është kronik dhe ende vazhdon të mbetet i pazgjidhur. Me këtë rast IKSHPK ka rekomanduar dhe kërkuar nga Komuna e Graçanicës, Komuna e Prishtinës dhe MMPH që në kuadër të kompetencave të tyre, t'i ndërmarrin veprimet e nevojshme, si masa të domosdoshme për tejkallimin e problemit aktual dhe mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve, për:
- rregullimin dhe mirëmbajtjen e shtratit të lumit Graçanka në tërë zonën;*
-të vazhdohet me inspektimin dhe hulumtimin e shkarkimeve të ujërave të ndotura, posaçërisht të substancës e cila në sipërfaqe të lumit definohet me ngjyrë të bardhë;

⁸ MMPH, Raport për Gjendjen e Ujërave në Republikën e Kosovës, 2015, fq.61, [https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Raporti_i_ujrave_i_2015_shqip_\(2\).pdf](https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Raporti_i_ujrave_i_2015_shqip_(2).pdf)

⁹ Shpenzimi Biokimik i Oksigjenit

-të vazhdohet me monitorim të rregullt të cilësisë së ujit përgjatë rrjedhës së lumit Graçanka;

-të pastrohet shtrati i lumit nga mbeturinat, largimi i shevarit si dhe largimi i shtresës së mbetur të llymit, me qëllim të lirimit të hapësirës për rrjedhje natyrore të ujit në lum;

-të zbatohen masat për mbrojtjen e resurseve të ujit në pajtim me legjislacionin e zbatueshëm për zonat e mbrojtura sanitare;

-Drejtoria e Shëndetësisë e Komunës së Graçanicës të raportoj për sëmundje ngjitëse dhe jo ngjitëse në Departamentin e Epodemologjisë në IKSHPK; etj.

Për më tepër IKSHPK ka dhënë edhe rekomandime specifike në lidhje me pastrimin nga mbeturinat, dislokimin e deponisë së mbeturinave krijimin e sistemit për menaxhimin e tyre, etj.

56. Duke pasur parasysh informatën e pranuar nga IKSHPK, sipas së cilës bazuar në të dhënat nga Departamenti i Epidemiologjisë, nuk bëhet asnjë raportim i çfarëdo natyre nga institucionet shëndetësore të Komunës së Graçanicës, të problemeve të shëndetësisë publike e në veçanti të sëmundjeve ngjitëse, Avokati i Popullit, vlerëson se mosveprimet e tilla janë në kundërshtim me interesin e qytetarëve dhe me nenin 17 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, sipas së cilit komunat kanë kompetencë ekskluzive në “shëndetësinë publike”.
57. Duke u nisur nga informatat e pranuar nga IKSHPK, lidhur me ndotjen e vazhdueshme të lumit Graçanka, Avokati i Popullit vlerëson se Komuna e Graçanicës ka dështuar të ofroj informacion për banorët e zonës së prekur nga ndotja rreth rrezeve për shëndetin dhe mirëqenien e tyre, si dhe të ndërmerre masat e duhura për të mbrojtur të drejtën për gëzimin e një mjedisi të shëndetshëm dhe të sigurt jetësor.
58. Avokati i Popullit, gjen që GjEDNJ, në rastin e ngjajshëm me çështjen, *Tatar v. Romania*, që kishte të bëjë me shkarkimin e ujërave të ndotura me përmbajtje të cianid natriumit në lum, nga një fabrikë e përpunimit të xehes së arit, dhe ndikimit në mjedis, edhe pse mungonte dokument zyrtar i cili do të vërtetonte në mënyrë të qartë ndikimin e aktivitetit në shëndetin e njeriut dhe mjedisin, Gjykata në bazë të studimeve të ndikimit në mjedis të shkarkimeve të paraqitura nga Shteti i paditur, konkludoi se ekzistonte kërcënim serioz dhe thelbësor për mirëqenien e aplikantëve, dhe shteti kishte obligim pozitiv të ndërmerre masa të arsyeshme, dhe të mjaftueshme për të mbrojtur të drejtat e palëve të interesuara, të ofronte informacion rreth rrezeve për shëndetin dhe mirëqenien e tyre, në mënyrë që të respektohej jeta e tyre private, shtëpitë e tyre, dhe, në përgjithësi, për të siguruar një mjedis të shëndetshëm, të sigurtë. Sipas gjykatës “*Aplikantët duhet të kenë jetuar në një gjendje ankthi dhe pasigurie të theksuar nga qasja pasive e autoriteteve kombëtare*” dhe frika për vazhdimin e aktivitetit”.
59. GjEDNJ, në rastin *Guerra dhe të tjerët kundër Italisë*, që ka të bëjë me mos arritjen e shtetit për përmbushjen e obligimeve të veta për parandalimin e ndotjes, ka vlerësuar se shteti i paditur nuk ka përmbushur detyrimin e tij pozitiv për të siguruar të drejtën e ankuesve për të respektuar jetën e tyre private dhe familjare, që bie në kundërshtim me nenin 8 të Konventës.
60. Edhe pse IAP është njoftuar nga Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore/Ministria se e njëjta ka nisur një kërkesë drejtuar komunave nëpërmjet të cilës ka kërkuar që komunat t'i paraqesin projekt propozimet në fushën e ujërave, duke përfshirë në mënyrë analitike

sfidat dhe nevojën për ndërmarrje të masave, IAP nuk është njoftuar se a ka pranuar ministria projekt propozim nga komuna e Graçanicës.

61. Për më tepër Autoriteti/Ministria si organ kompetent për hartimin e planeve për menaxhim e ujërave¹⁰, nuk ka ofruar asnjë informatë në përgjigjen e tij, e cila do të dëshmonte planet për përmirësimin e gjendjes së lumit Graçanka, e sidomos planet lidhur me ndërtimet e impianteve për trajtimin e ujërave të zeza, edhe pse Ligji për Ujërat, në nenin 26, par 3, [Regjimi i ujërave] specifikon që: ...*“Intervenimet me qëllim të përmirësimit, rehabilitimit dhe mirëmbajtjes së gjendjes së mirë të ujërave, kryhen në pajtim me planet për menaxhim të pellgjeve lumore”*
62. Edhe pse, bazuar në përgjigjen e datës 28 janar 2020, të pranuar nga Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore, IAP, është njoftuar se MMPH nëpërmjet projektit të implementuar në vitin 2019, ka vazhduar me pastrimin dhe rregullimin e rrjedhës së lumit deri te kisha e Llapna Sellës, bazuar në gjendjen në terren Avokati i Popullit, konsideron se çfarëdo mase e ndërmarrë deri më tani nga autoritetet relevante, ka rezultuar pa sukses për zgjidhjen efektive të rastit. Po ashtu, Avokati i Popullit, vlerëson se njoftim i pranuar nga Autoriteti, kishte mungesë të sqarimeve të nevojshme, referim të gabuar të bazës ligjore, dhe bie ndesh me gjendjen në terren të verifikuar nga vetë zyrtarët e IAP, dhe po ashtu, me informatat e raportit të IKSHPK, datë 14 shkurt 2020, i cili vlerëson ndotje të rëndë të lumit në fjalë.
63. Kuvendi i Republikës së Kosovës më 25 janar 2018 ka miratuar rezolutën për Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm. Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, ofron një plan të përbashkët për paqen dhe prosperitetin për njerëzit dhe planetin tonë, për tani dhe në të ardhmen. 17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm janë një thirrje urgjente për veprim për të gjitha vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim për një partneritet global në zbatimin e tyre. Objektiv 6.3 shprehimisht potencon përmirësimin e cilësisë së ujit duke përgjysmuar përqindjen e sasisë së ujërave të zeza: *“6.3 Deri në vitin 2030, të përmirësohet cilësia e ujit duke zvogëluar ndotjen, duke eliminuar hedhjen e mbetjeve jashtë vendit të përcaktuar dhe duke minimizuar shkarkimin e kimikateve dhe të materialeve të tjera të rrezikshme, duke përgjysmuar përqindjen e sasisë së ujërave të zeza të patrajuara dhe duke rritur ndjeshëm riciklimin dhe ripërdorimin e sigurt në nivel global.”*

Konstatimi i Avokatit të Popullit

64. Avokati i Popullit, në bazë të të gjeturave dhe fakteve të mbledhura, analizës në mes të Instrumenteve Ndërkombëtare, Kushtetutës së vendit, si dhe ligjeve relevante, të cilat garantojnë respektimin e të drejtat e njeriut, dhe përcaktojnë rregullat për përmbushjen e obligimeve pozitive nga shteti, konstaton se mos arritja e përmbushjes së përgjegjësive nga autoritetet kompetente për mbrojtjen e lumit nëpërmjet masave efektive, ka ndikuar në kufizimin e të drejtës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm të garantuar në nenin 52, të Kushtetutës, të drejtën e privatësisë, me mundësi të cenimit të së drejtës për jetën.

¹⁰ Ligji për Ujërat e Kosovës, neni 22, par. 1.6, Detyrat dhe përgjegjësitë e Autoritetit, *“harton planet për menaxhim e ujërave për pellgun;”*

65. Avokati i Popullit, vlerëson se komunat Graçanicë dhe Prishtinë, dhe në veçanti Ministria nuk kanë arritur të të ndërmarrin veprimeve efektive për mbrojtjen dhe sanimin e ndotjes së lumit Graçanka, dhe zbatimin e legjislacionit në fuqi, përkundër ndikimit të ndotjes në zhvillimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të lumit, dhe ndikimit shëndetin publik dhe mjedis.
66. Avokati i Popullit, bazuar në përgjigjen e pranuar nga Autoriteti/ ministria, vlerëson se Ministria nuk ka arritur të përmbush obligimin ligjor për zbatimin e ligjit për ujërat dhe dhe ligjet tjera nga fusha e mjedisit jetësor, të cilat do të siguronin mbrojtjen e lumit Graçanka, dhe po ashtu nuk ka arritur të dëshmoj se ka hartuar plane të cilat do të garantonin përmirësimin e lumit Graçanka, është i planifikuar nëpërmjet planit të veçantë.
67. Avokati i Popullit, në mungesë të dëshmive të cilat do të argumentonin ndërmarrjen e masave inspektuese nga inspektoratet e dy niveleve, konstaton mos arritje të përmbushjes së obligimeve ligjore nga nga inspektoratet e dy niveleve, përkundër të margjinës së gjerë të përgjegjësive të përcaktuar me ligjin në fuqi.
68. Avokati i Popullit, konsideron se mos bashkëpunimi i komunave dhe i ministrisë, është tregues i mjaftueshëm për mungesën e interesimit për gjetjen e mundësive për zgjidhjen e çështjes që do të garantonte respektimin e të drejtës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, që bie ndesh me nenin 52 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës [Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor], e cila përcakton obligimin e të gjithëve për mbrojtjen e mjedisit jetësor.
69. Avokati i Popullit, duke rikujtuar se një mjedis i sigurt dhe i shëndetshëm është i nevojshëm për gëzimin e plotë të të drejtave të njeriut, bazuar në nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: “[...] ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore” dhe në pajtim me nenin 18 paragrafi 1.2, të Ligjit nr. 05/L-019, për Avokatin e Popullit, i:

REKOMANDON

1. *Komuna e Graçanicës, në pajtim me kompetencat dhe autorizimet ligjore, të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme dhe efektive për frenimin e ndotjes dhe pastrimin e lumit Graçanka në Graçanicë.*
2. *Komuna e Prishtinës, në pajtim me kompetencat dhe autorizimet ligjore, të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme dhe efektive për frenimin e ndotjes dhe pastrimin e lumit Graçanka brenda territorit të saj.*
3. *Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, në pajtim me kompetencat dhe autorizimet ligjore dhe në bashkëpunim me të gjitha autoritetet relevante komunale të përcjellë dhe mbikëqyrë punët dhe aktivitetet e ndërmarra për mbrojtjen e lumit nga ndotja.*
4. *Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale e komunës së Graçanicës, ti raportoj IKSHPK, lidhur me gjendjen epidemiologjike dhe shëndetësore të banorëve.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë

atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, (...) duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), mirësisht ju lutemi të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Më nderime,

Hilmi Jashari

Avokat i Popullit

Bashkëngjitur:

Raporti i Institutit Kombëtar i Shëndetësisë Publike, i datës 14 shkurt 2020, për vlerësimin e gjendjes sanitaro-higjienike dhe epidemiologjike në lumin Graçanka në Llapna Sellë